




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Општина Грачаница
Komuna e Graçanicës
Municipality of Gračanica



Në bazë të nenit 11 dhe nenit 12 paragrafi 2 pika d) lidhur me nenet 28, 29 dhe nenit 40 paragrafi 2 pika j) të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e RK-së" nr.28/2008), nenit 8 paragrafi 2 të Ligjit nr.04/L-010 për bashkëpunimin ndërkomunal ("Gazeta zyrtare e RK-së" nr.7/2011), nenit 46 paragrafi 2 të Statutit të Komunës së Graçanicës nr.6320/15 të datës 22.10.2015, Kuvendi i Komunës së Graçanicës në mbledhjen në mbledhjen e tretë të rregullt, e mbajtur më datën 26.06.2026, merr këtë:

VENDIM Nr.39/2026/KG

për miratimin e Marrëveshjes për bashkëpunimin ndërkomunal

Neni 1

Miratohet Marrëveshja për bashkëpunimin ndërkomunal të lidhur midis Komunës së Zubin Potokut (nr.protokolli 273 e datës 17.06.2026) dhe Komunës së Graçanicës (nr.protokolli 2638/26 e datës 17.06.2026).

Neni 2

Marrëveshja sipas nenit 1 të këtij Vendimi është brenda kompetencave të komunave përkatëse dhe synon të koordinojë aktivitetet ndërkomunale midis dy komunave në aspektin e ofrimit të mbështetjes administrative, profesionale dhe teknike nga Komuna e Graçanicës për Komunën e Zubin Potokut, me qëllim të përmirësimit të kapacitetit të komunës në ushtrimin e kompetencave të saj të besuara ligjërisht në fushat e menaxhimit të burimeve njerëzore, menaxhimit financiar dhe prokurimit publik.

Neni 3

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Marrëveshja për bashkëpunimin ndërkomunal, e nënshkruar nga kryetarët e komunave të lartpërmendura si përfaqësues të institucioneve shtetërore në nivel lokal, të cekur në nenin 1 të këtij Vendimi.


Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi janë përgjegjës: Kryetari i Komunës së Graçanicës dhe drejtoritë komunale, varësisht nga fushëveprimi i tyre i punës.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi 30 ditë pas dorëzimit tek autoriteti mbikëqyrës në kuptimin e nenit 8 lidhur me nenin 9 të Ligjit nr. 08/L-284 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe pas publikimit në ueb-faqen zyrtare të komunës.

Kryesuesi i Kuvendit


Milan Dimitrijević

